



Të nderuar studentë,

Studentët të cilët janë në prag të përfundimit të provimeve të tyre dhe të cilët dëshirojnë të fillojnë me procesin e punimit të diplomës, lutem të kenë parasysh hapat në vijim:

Studenti fillimisht paraqet kërkesën për temë të masterit. Studenti propozon temën, në rast se studentin nuk ka ende një temë të caktuar, atëherë kjo mund të bëhet me ndihmën e fakultetit. Kërkesa duhet të përmbajë lëndën e studimit, qëllimin, metodat e punës dhe hipotezat fillestare se ku synohet të arrihet.


Kërkesa e studentit kalon në këshillin e fakultetit, i cili cakton komisionet përkatëse për aprovim, vlerësim dhe për mbrojtjen finale të temës së diplomës.

Në momentin e aprovimit të temës, komisioni cakton mentorin e temës, i cili miratohet apo jo nga këshilli i fakultetit.

Për detaje më të hollësishme rreth hapave të cilët duhet të ndjekën gjatë procesit të diplomimit, ju lutem gjeni të bashkëngjitur udhëzuesin për procesin e diplomimit në UBT.

Për të gjitha pyetjet që keni ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni.

Gjithë të mirat,
Artan Tahiri





Komisionin për pranimin e tezës



Komisionin përbëhet prej 3 anëtareve, dy prej të cilëve duhen të jenë të fushës



Komisioni për pranim të tezës është i obliguar që në afat prej dy muajsh (pa llogaritur këtu pushimet vjetore) t'i paraqes raport me shkrim kolegjiut të studimeve për master në lidhje me kërkesën e studentit



Raportin e komisionit bashkë me vërejtjet eventuale të Kolegjiut të studimeve për master i shqyrton Këshilli i departamentit përkatës. Në rast të vlerësimit pozitiv, departamenti përcakton mentorin e kandidatit dhe i propozon Këshillit shkencor-mësimor të fakultetit të miratoj raportin e komisionit dhe të emëroj mentorin.

Komisionin për vlerësimin e dorëshkrimit të tezës



Komisioni është i obliguar që në afat prej tre muajsh (pa llogaritur pushimet vjetore) t'i paraqes raport me shkrim këshillit shkencor mësimor të fakultetit via kolegjiut- këshilli i departamentit. Raporti mund të jetë i përbashkët apo secili anëtar i komisionit mund të bëjë raport të veçantë sipas vlerësimit të vet.



Nëse komisioni vendosë që punimi të plotësohet apo të ripunohet, atëherë i njëjti duhet të paraqitet edhe një herë për vlerësim jo më shpejt se 6 muaj dhe jo më vonë se 12 muaj. Në të kundërtën kandidati duhet të bëjë kërkesë për ndërrim të tezës



Punimi i vlerësuar pozitivisht vihet në diskutim publik në një afat prej 30 ditësh, me ç'rast të interesuarit mund të bëjnë vërejtjet sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia paraqesin Kolegjiumit të studimeve për master



Pas kalimit të aftit për diskutim publik, Këshilli shkencor-mësimor i fakultetit, e sipas propozimit të departamentit, aprovon raportin e komisionit dhe emëron komisionin për mbrojtje të tezës.



Datën e mbrojtjes së tezës e cakton komisioni në marrëveshje me dekanin e fakultetit dhe me kandidatin. Data e mbrojtjes duhet të publikohet në mjete të informimit të paktën një javë para ditës së mbrojtjes.



Komisioni për mbrojtje përbëhet, nga:

1. Kryetari i Komisionit;
2. Mentori
3. Anëtari



Kërkesës për mbrojtje i bashkangjiten:

1. Punimi i studentit në pesë kopje dhe në CD
2. Listën e punimeve profesionale dhe shkencore,
3. Shënimet biografike



Në dosjen e studentit në Fakultet duhet të vendosen:

1. Raportin e komisionit për pranim të tezës;
2. Raportin e komisionit për vlerësim të tezës
3. Pasqyra e notave që i ka përfunduar obligimet sipas Planit dhe programit të studimeve;
4. Vendimi i Komisionit, dhe
5. Procesverbalin e mbrojtjes

**Veprimet administrative nga Shërbimi i
Studenteve**



**Verifikon se studenti a i ka plotësuar kushtet
në përputhje me planin dhe programin e
studimeve, para daljes në mbrojtje publike
nga ana e studentit**



**Zyra e financave lëshon dëshmin se student
nuk ka obligime financiare në bazë të
kontratës**





Në dosjen e studentit të diplomuar arkivon:

1. Dëshmin që provimet I ka të përfunduara në përputhje me planin dhe programin e studimeve;
2. Dëshmin që nuk ka obligime financiare;
3. Raportin e komisionit për pranim të tezës;
4. Raportin e komisionit për vlerësim të tezës
5. Vendimi i Komisionit, dhe
6. Procesverbalin e mbrojtjes
7. Punimin e tezës



Dokumentat që duhet të plotësohen nga Shërbimi I Studentave:

1. Libri amë i studenteve;
2. Libri i të diplomuarve



Dokumentat që duhet t'i lëshojë studentit:

1. Certifikatën e diplomimit;
2. Diplomën;
3. Diploma Supplementin;
4. Certifikatën e notave